



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISE KORCE**

**VENDIM**

Nr 60 date 14.07.2010

**Per fillimin e procedurave te ankandit per shitjen e objekteve te sekuestruara**

Keshilli i Bashkise Korce pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe bazuar në nenin 32/e te ligjit 8652, date 31.07.2000 “Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, 19/c te ligjit 7697 date 07.04.1993 “Per kundravajtjet administrative”, i ndryshuar dhe nenin 4/ç te ligjit 9874 date 14.02.2008 “Per ankandin publik” si dhe mbas diskutimeve te Keshilltareve

**VENDOSI**

1. Te miratoje shitjen e objekteve te sekuestruara nga Drejtoria e Policise Bashkiake dhe Drejtoria e Kontroll Territorit
2. Te autorizoj fillimin e procedurave te ankandit publik
3. Te ngarkohet Kryetari i Bashkise per marjen e masave per realizimin e ankandit ne përputhje me ligjin 9874 date 14.02.2008 “Per ankandin publik” dhe lidhjen e kontrates me ofertuesin-fitues.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

**KRYETAR**

**Gjergji PENDAVINJI**